



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVA
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT / MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORTS
Nr. Njes. 04 Shenja klas. 63
Nr. Prot. Viti 2368/2024
Data 02.05.2024
Nënshkrimi: [Signature]
Printim

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT
MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA
MINISTRY OF CULTURE, YOUTH, SPORTS

Departamenti i Kulturës / Departman za Kultururu / Department of Culture

Bazuar në Vendimin e Ministrit me Nr.52/2024 të datës 02.05.2024 për ndarjen e Çmimeve për Kinematografi, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit shpall:

KONKURS

Për Çmimet që i ndanë Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në fushën e Kinematografisë.

Ftohen të interesuarit që të propozojnë kandidatët për Çmimin Kombëtar për Vepër Jetësore "Bekim Fehmiu" dhe "Çmimin vjetor për Kinematografi" që u jepet krijuesëve të dalluar, të cilët me krijimtarinë e tyre kanë lënë gjurmë të thella në fushën e kinematografisë për vitin 2023.

Çmimi Kombëtar për Vepër Jetësore "Bekim Fehmiu".

- Ky Çmim u ndahet personaliteteve të shquara të fushës së Kinematografisë për suksesin, të arriturat gjatë karrierës, risitë dhe kontributin e veçantë në avancimin e Kinematografisë. Ky Çmim mund të ndahet edhe pas vdekjes së autorit.
- Laureatë të Çmimit mund të jenë: producentët, regjisorët, skenaristët, aktorët, drejtorit i fotografisë, skenografët, kostumografët, kompozitorët, animatorët dhe krijuesit, të cilët në mënyrë kreative kontribuojnë në Kinematografi.
- Çmimi u ndahet vetëm shtetasëve të Republikës së Kosovës.

"Çmimi Vjetor për Kinematografi"

- Ky Çmim i ndahet, çdo vit, autorit për veprat filmike të realizuara gjatë vitit paraprak kalendarik.
- Çmimi Vjetor për Kinematografi, sipas Vendimit të Jurisë, ndahet çdo vit vetëm në njerën nga këto kategori: producenti më i mirë, regjisori më i mirë, skenaristi më i mirë, aktori/a më i/e mirë, drejtori i fotografisë më i mirë, skenografi më i mirë, kostumografi më i mirë, kompozitori më i mirë dhe animatori më i mirë.
- Çmimi u ndahet vetëm shtetasëve të Republikës së Kosovës.

Konkurrimi për Çmimet për Kinematografi mund të bëhet nëpërmjet propozimit nga:

1. Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Kosovës;
 2. Qendra Kinematografike e Kosovës;
 3. Fakulteti i Arteve në Universitetin e Prishtinës.
 4. Produksionet Filmike të regjistruara në Kosovë;
 5. Shoqatat e Filmit të regjistruara në Kosovë;
- Vlerësimin për ndarjen e Çmimeve e bën Juria profesionale e përbërë nga 5 anëtarë.
 - Propozimet që bëhet nga Institucionet e lartpërmendura duhet të përmbajnë: arsyetimin me shkrim, CV e të nominuarit dhe materialet e tjera përcjellëse audiovizuale për të nominuarin.
 - Propozimi duhet të firmoset nga titullari i Institucionit/Asociacionit që ka të drejtën e propozimit.
 - Propozimi me shkrim duhet të dërgohet jo më larg se 30 ditë nga dita e shpalljes së Konkursit në faqen zyrtare të MKRS - www.mkrs-ks.org, në Arkivin e MKRS-së, për Departamentin e Kulturës, në Zyrën nr. 022 (Adresa: MKRS, 10.000 Prishtinë, Rruga “Nëna Terezë” nr. 35).

Propozimet me dokumentacion të pa kompletuar nuk do të shqyrtohen.

Prishtinë, 02.05.2024